



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.24, datë.09.07.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“IMPIANT ENERGJITIK ME CIKËL TË KOMBINUAR, 1 DHE 2 KAT ME 1 KAT
NËNTOKË” ME VENDNDODHJE NË BASHKINË ROSKOVEC

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues Shoqërinë “Fier Thermoelectric”sh.a.

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Impiant Energjetik me cikël të kombinuar, 1 dhe 2 kat me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje Bashkia Roskovec, me subjekt zhvillues “Fier Thermoelectric”sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 25.08.2024